

VENDIM
Nr. 248, datë 27.4.2007

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 837, datë 29.7.2009)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucion juridik publik, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka objekt të veprimtarisë:

a) Hartimin dhe zbatimin e politikave, të strategjive, akteve, ligjore dhe nënligjore, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (SHI);

c) Bashkërendimin e politikave dhe të programeve në fushën e SHI-së;

ç) Nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së;

d) Promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së;

dh) Edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-së nga publiku.

3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka këto detyra dhe përgjegjësi specifike:

a) Harton strategjinë kombëtare për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj;

b) Përgatit bazën ligjore për zhvillimin e SHI-së;

c) Bashkërendon reformat, programet dhe projektet në fushën e SHI-së, që zbatohen në të gjitha institucionet publike;

ç) Përcakton standardet TIK, që do të përdorin Kryeministria, ministrinë dhe institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit/ministrit. Këto standarde publikohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Në rastet kur standardet mungojnë dhe/ose janë të pazbatueshme, institucionet e mësipërme janë të detyruara, në çdo rast, të marrin, përpara fillimit të procedurave të prokurimit publik, mendimin e AKSHI-t;

d) Zhvillon një rrjet të brendshëm të TIK-së për administratën publike, përfshi krijimin e rrjetit qeveritar (*GovNet*) dhe të portalit qeveritar;

dh) Bashkërendon projektet për kompjuterizimin e të gjithë sektorëve të administratës publike, duke i dhënë përparësi kompjuterizimit të institucioneve, që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për publikun dhe bizneset;

e) Drejton strategjinë dhe projektet për ngritjen e shërbimeve *on line* të administratës publike, përfshi të gjitha shërbimet e qeverisjes elektronike;

ë) Mbështet dhe bashkërendon projektet për dixhitalizimin e bazës ligjore, të dokumentacionit, arkivave, bibliotekave, etj;

f) Nxit dhe mbështet përdorimin e internetit dhe TIK-së në shkolla, përfshi kompjuterizimin dhe aksesin në internet të të gjitha shkollave publike;

g) Nxit dhe mbështet zhvillimin e biznesit *on line* (ebusiness);

gj) Propozon politika, nxitëse dhe mbështetëse, për zhvillimin e infrastrukturës së TIK-së dhe të investimeve private në këtë fushë;

h) Promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet *on line*;

i) Promovon dhe mbështet rritjen e aftësive për përdorimin e kompjuterit dhe të internetit nga qytetarët;

k) Bashkëpunon në fushën e SHI-së me institucione të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

l) Gjatë planifikimit të projektbuxhetit të shtetit, Ministria e Financave duhet të marrë mendimin e AKSHI-t, i cili është organ teknik-këshillimor i institucioneve, të përmendura në shkronjën "ç", për kërkesat e tyre, për financimin me fonde buxhetore të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

5. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga projekte të ndryshme, nga institucione të huaja, si dhe nga burime të tjera, të ligjshme.

6. Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit.

7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj Agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Pranimi në punë bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

8. Efektet financiare, në shumën 33 282 368 (tridhjetë e tre milionë e dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha